



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Pejë 07.03.2024,

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejes (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik **ODISEJA SH.P.K.** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **084 Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal ne Komunen e Pejes.** , nrprok te brendeshem. 635-24-009-221 // 635-24-1274-2-2-1 dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

VENDIM

Cilësohet e **pjeserisht e bazuara** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik **ODISEJA SH.P.K.** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **084 Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal ne Komunen e Pejes**

SQARIM

Me datën **06.03.2024**, operatoi ekonomik **ODISEJA SH.P.K.** ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (**KOMUNA E PEJES**) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si me poshtë:

Pretendimi e O.E Nr.1:

-Me 06.03.2023 eshte ndryshuar dosja e tenderit ku nga Kerkesa 1 per kontrata te ngjajshme nga 2kerkesa per smart city ka reduktuar ne 1kontrate ku dhe ka ulur vleren e kontrates qe te favorizoj kompanine X. Dhe nuk ka ofruar mundesine qe qe te deshmohet pervoja e punes edhe me sinjalizim vertikal dhe horizontal.

Ne sqarimet qe i ka bere me heret ka pretenduar qe ne paramase dhe parallogari do te kryhen kesi pune por nuk i ka permend fare sinjalizimin vertikal dhe horizontal por vetem smart city ne vleren e caktuar ku kjo qartas bie ne kundershtrim me ligjin.

Andaj kerkojme nga ana juaj qe te ri -shiqoni kerkesen

Pergjigja nga A.K Nr.1 :

Duke u bazuar ne kerkesen per rishqyrtim te dates 06.03.2024 , ju njoftojm se ne si A.K kemi vepruar konform specifikave te njesis kerkuese dhe ju njoftojm se pretendimet e juaj lidhur me kerkesen 1 te Lista e kontratave permisohet sipas LPP-se dhe ankesa juaj eshte pjeserisht e bazuar dhe korigjimin do te keni ne **B54 Formulari standard per korigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.**

Pretendimi e O.E Nr.2:

-Ne informata shtese me heret ju kemi kerkuar qe te ofrohet marreveshje per paisjet kurse AK, kete pike e ka aprovuar por te ofrohet marreveshja e noterizuar ketu verehet nje shkelje dirkte e barazise se konkurences duke e pasur parasysh qe paisjet do te merren ne shfrytezim jashte Kosoves, dhe si e tille marreveshja para noteri eshte nje problem per shume kompani .

Pergjigja nga A.K Nr.1 :

Pikrisht ju vete keni deklaruar se A.K ka aprovuar kerkesen tek lista e paisjeve ku me heret ka qen qe paisjet O,E duhet ti kete te vetat por pas kerkeses nga O,E kemi bere ndryshimin ku kemi kerkuar qe lista e paisjeve O,E mund ti kete te vetat apo edhe ti mere ne huazim siq e kemi cekur

Vëmendje!

Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.

Ju njoftojm se kriteri i ndryshuar eshte ne perputheshmeri me LPP-ne dhe ju njoftojm se pretendimet e juaja ne ket pike jane te **pa bazuara**.

Ne si A.K Komuna e Pejes ju njoftojm se do veprojm konform **LPP-se** dhe ju njoftojm se **Hapja e Ofertave** do behet me daten **15.03.2024 ne ora 14:00** ne sistemin e e-prokurimit , dhe do ju njoftojm se te gjitha korrigjimet do ti keni **ne B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara**.

Sinqerisht,

Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit

